



**Edukimi në Vazhdim  
i Profesionistëve të Shëndetësisë  
2015 - 2018**

## 1. HYRJE

Zhvillimi i vazhdueshëm profesional/Edukimi në Vazhdim (EV) tashmë përfaqëson një normë për profesionistët e kujdesit shëndetësor në Shqipëri. Ai është një kusht i rëndësishëm për përmbushjen me sukses të misionit të tyre për ofrimin e shërbimeve shëndetësore me cilësi dhe në përputhje me standardet bashkëkohore.

Sistemi i detyrueshëm i edukimit në vazhdim në Shqipëri i nisur që prej vitit 2010 është konsoliduar dhe përmirësuar më tej në vitet 2015 -2018. Në fund të viti 2018 u përmbyll cikli i dytë katërvjecar i programit të certifikimit. Gjatë viteve që përfshin ky cikël janë bërë disa përmirësime dhe ndryshime të kuadrit ligjor që kanë ndikuar si tek profesionistët e shëndetësisë në procesin e certifikimit ashtu dhe tek ofruesit në procesin e akreditimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim.

Së pari, përfshirja e infermierëve në programin e certifikimit që prej 1 janarit 2016 përfaqëson një zhvillim shumë të rëndësishëm. Për infermierët, ashtu si për mjekët, është po aq i rëndësishëm përmirësimi dhe përditësimi i dijeve dhe aftësive të tyre përmes programeve të edukimit të vazhdueshëm. Kjo risi e sistemit të edukimit në vazhdim do t'i shërbejë zhvillimit e forcimit të kujdesit infermieror, që është i një rëndësie të veçantë.

Së dyti, në maj të 2017-tës u miratua kuadri ligjor për akreditimin e ofruesve të aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë, që shënon fillimin e një etape të re në sistemin e akreditimit. Deri në fund të vitit 2018-të janë akredituar tre ofrues me eksperiencë: Universiteti i Mjekësisë Tiranë (UMT), Albanian University dhe Swiss Foundation for Innovation. Këta ofrues falë eksperiencës dhe standardeve të treguara në vite kanë të gjithë ekspertizën e nevojshme për t'i kryer vetë akreditimet e aktiviteteve të edukimit në vazhdim që ato organizojnë. QKEV do të luajë rol mbikqyrës, monitorues dhe këshillues në mënyrë periodike, duke marrë dhe masat përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.

Së treti, janë forcuar kriteret e akreditimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim me synim rritjen e cilësisë së tyre. Kriteret e reja promovojnë organizimin e aktiviteteve me një numër të ulët pjesëmarrësish, të cilat konsiderohen më cilësore, lejojnë interaktivitet dhe pjesëmarrje aktive dhe kanë një përqindje më të lartë të përvetësimit të dijeve nga profesionistët e shëndetësisë pjesëmarrës në to. Gjithashtu janë forcuar kërkesat për akreditimin e aktiviteteve të edukimit në distancë, me qëllim rritjen e cilësisë së tyre. Eksperienca e QKEV me akreditimin dhe monitorimin e aktiviteteve të edukimit në distancë tregoi që cilësia e aktiviteteve e tyre linte për të dëshiruar. Kjo ishte rrjedhojë e kapaciteteve të ulëta të ofruesve nga pikëpamja e teknologjisë së përdorur si dhe pamundësisë së QKEV për të verifikuar siç duhet zhvillimin efektiv të këtyre aktiviteteve.

Funksionimi dhe përmirësimi i sistemit të edukimit në vazhdim në Shqipëri është bërë falë një bashkëpunimi të ngushtë të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MShMS) dhe QKEV-së me të gjithë aktorët e tjerë të rëndësishëm në këtë fushë, si urdhrat dhe shoqatat e profesionistëve, institucionet akademike dhe institucionet shëndetësore. Përmes këtij procesi gjithëpërfshirës është bërë e mundur që të gjitha procedurat, kriteret dhe standardet e akreditimit të aktiviteteve të edukimit në

vazhdim si dhe të certifikimit të profesionistëve të shëndetësisë të mirëpritën e mbështeten nga të gjithë grupet e interesit.

## 2. CERTIFIKIMI I PROFESIONISTËVE TË SHËNDETËSISË

Programi i certifikimit për profesionistët e shëndetësisë bazuar në VKM 789 datë 22/9/2015 “Për përcaktimin e kriterëve, standardeve dhe procedurave të programit të certifikimit për profesionistët e shëndetësisë” përfshiu periudhën katërvjeçare Janar 2015 – Dhjetor 2018. Brenda kësaj periudhe profesionistët e përfshirë në program kishin detyrim të mblidhnin një numër të caktuar kreditesh të edukimit në vazhdim, që sipas kategorive ishte: 120 kredite për mjekët, 60 kredite për farmacistët e stomatologët dhe 40 kredite për infermierët. Kreditet e përfituara nga aktivitetet e edukimit në vazhdim me temë të lidhur drejtpërdrejt me specialitetin e profesionistit duhet të përbëjnë të paktën 50% të numrit të përgjithshëm të krediteve, kreditet e përfituara nga aktivitetet e edukimit në distancë duhet të përbëjnë jo më shumë se 50% të numrit të përgjithshëm të krediteve të raportuara dhe kreditet e përfituara nga aktivitetet e vetëraportuara mund të përllogariten deri në 20% të numrit të përgjithshëm të krediteve të marra nga profesionisti. Pjesa tjetër e krediteve të nevojshme përcaktohet nga zgjedhja e lirë e profesionistit, në bazë të nevojave individuale.

### 2.a. Regjistrimi i profesionistëve të shëndetësisë

Në fund të vitit 2018 numri i profesionistëve të regjistruar ka arritur në 36,822, nga të cilët 1,681 janë profesionistë jo-aktivë. Në grupin e profesionistëve jo-aktivë përfshihen ata profesionistë që janë në periudhë specializimi, me raport leje lindje apo shkëputje nga puna për një periudhë kohore më shumë se 4 muaj, si dhe të gjithë ata që kanë pezulluar lejen e ushtrimit të profesionit pranë urdhrat përkatës. Tabela 1 paraqet numrin e detajuar të profesionistëve sipas profesioneve.

**Tabela 1. Numri i profesionistëve të regjistruar sipas profesioneve**

PROFESIONI	Numri i profesionistëve në fund të 2018		
	AKTIV	JO-AKTIV	TOTAL
Mjek	6,222	939	7,120
Stomatolog	2,973	392	3,259
Farmacist	3,125	165	3,338
Infermier & mami	22,769	248	22,864
<b>Total</b>	<b>35,089</b>	<b>1,744</b>	<b>36,581</b>


QKEV ka regjistruar rreth 6500 profesionistë të rinj në periudhën 2015-2018 dhe ka saktësuar të dhënat në kartelat personale për afro 20000 profesionistë. Regjistrimi i profesionistëve në programin e certifikimit është bërë mbi bazën e listave të marra nga Urdhrat profesionalë si dhe nga regjistrimet individuale të kryera nëpërmjet formularëve të regjistrimit. Regjistri i profesionistëve paraqet shumë pasaktësi sepse jo të gjithë profesionistët janë regjistruar vetë pranë QKEV, siç kërkon ligji. QKEV ende nuk ka marrë nga Urdhri i Mjekut dhe Urdhri i Infermierit të dhënat që lidhen me vlefshmërinë e lejeve e ushtrimit të profesionit dhe kohën e lëshimit të tyre.

Gjithashtu, institucionet përkatëse nuk kanë njoftuar QKEV për ndryshimet e statusit të profesionistëve në lidhje me ndryshimin e qendrës së punës, largimin nga Shqipëria apo ndryshimet në statusin e gjendjes civile.

## 2.b Numri i profesionistëve me detyrim të kryer dhe të pa kryer

Në grafikun 1 paraqitet numri i profesionistëve me detyrim të kryer dhe të pakryer sipas profesioneve.


**Grafiku 1. Profesionistë me detyrim të kryer dhe të pakryer**



Në grupin e profesionistëve me detyrim të pakryer përfshihen profesionistët të cilët kanë marrë kredite më pak se numri i kërkuar si dhe ata që kanë marrë 0 kredite. Këta të fundit janë në total 2,251 profesionistë, nga të cilët 1,331 mjekë, 585 stomatologë dhe 335 farmacistë.

Gjatë periudhës 2015-2018 pjesëmarrja e profesionistëve në aktivitete të edukimit në vazhdim paraqitet pothuaj e njëtrajtshme nga një vit në tjetrin për mjekët, farmacistët e stomatologët, ndërsa për infermierët ka një rritje të ndjeshme në vitin 2016, që është viti kur filloi programi i detyrueshëm i edukimit në vazhdim për ta. ( Graf.2).

**Grafiku 2. Numri i profesionistëve që kanë marrë pjesë në aktivitete të edukimit në vazhdim**



## 2.c. Përmbushja e kriterit “Kredite të lidhura me specialitetin e profesionistit”


Kreditet e përftuara nga aktivitete të EV dhe të lidhura drejtpërdrejt me specialitetin e profesionistit duhet të përbëjnë të paktën 50% të numrit të përgjithshëm të krediteve (mjekët 60 kredite, stomatologët e farmacistët 30 kredite dhe infermierët 20 kredite). Siç shihet nga tabela 2 ky kriter është përmbushur në nivel kombëtar për të gjitha profesionet.

<b>Tabela 2. Shpërndarja e krediteve të profesionistëve sipas fokusit të aktivitetit</b>			
<b>Profesioni</b>	<b>Fokusi i Aktivitetit</b>	<b>Kreditet</b>	<b>%</b>
Mjek	Jo-Specialitet	101,014	12.90%
	Specialitet	682,126	87.10%
<b>Total</b>		<b>783,140</b>	
Stomatolog	Jo-Specialitet	32,500	12.06%
	Specialitet	237,044	87.94%
<b>Total</b>		<b>269,544</b>	
Farmacist	Jo-Specialitet	39,726	18.08%
	Specialitet	180,053	81.92%
<b>Total</b>		<b>219,778</b>	
Infermier	Jo-Specialitet	64,795	13.84%
	Specialitet	403,417	86.16%

## 2.d. Kreditet e marra sipas llojit të aktivitetit.

Për mjekët, analiza e bërë sipas llojit të aktivitetit tregon se përqindja më e lartë e krediteve është marrë nga konferencat dhe më pak nga trajnimet. Me gjithë rëndësinë e tyre, konferencat nuk përfaqësojnë formën më efektive të edukimit në vazhdim. Një paraqitje më e detajuar e shpërndarjes së krediteve sipas llojit të aktivitetit jepet në grafikun 3.


**Grafiku 3. Shpërndarja e krediteve sipas llojit të aktivitetit për mjekët**



Siç shihet vetëm një pjesë shumë e vogël, 2% e krediteve janë marrë nga aktivitetet e edukimit në distancë.


Tendenca për të ndjekur konferenca vërehet edhe më e theksuar tek stomatologët. Nga grafiku i mëposhtëm vihet re që më shumë se gjysma e krediteve për stomatologët janë marrë nga konferencat dhe shumë më pak nga aktivitete si seminare trajnime e ëorkshop-e.

**Grafiku 4. Shpërndarja e krediteve sipas llojit të aktivitetit për stomatologët**




Nje situatë e ngjashme paraqitet edhe për farmacistët. Ajo që bie në sy është preferenca e farmacistëve për të ndjekur aktivitete të edukimit në distancë më shumë se mjekët dhe stomatologët. Kjo mund të shpjgohet edhe me natyrën e punë së farmacistëve, dhe mundësinë e tyre për t'i ndjekur aktivitetet nga vendi i punës.

**Grafiku 5. Shpërndarja e krediteve sipas llojit të aktivitetit për farmacistët**




## 2.e. Kreditet e marra sipas ofruesit të aktivitetit.

Vihet re se për kategorinë e mjekëve pjesa më e madhe e krediteve janë marrë nga aktivitete të organizuara nga shoqatat e profesionistëve si dhe nga aktivitete të paakredituara paraprakisht nga QKEV. Mbetet shumë për të bërë për aktivitetet e ofruara nga vetë institucionet shëndetësore të cilat nuk kanë arritur në masën 30 % sic përcakton VKM Nr. 789, datë 22.9.2015 për “Përcaktimin e Kriteve, Standardeve dhe Procedurave të Programit të Certifikimit për Profesionistë të Shëndetësisë”




Për stomatologët vërehet gjithashtu përqindje e lartë e krediteve të marra nga aktivitete të EV të organizuara nga shoqatat e profesionistëve dhe nga aktivitete të paakredituara paraprakisht nga QKEV.




Nga analiza e krediteve të marra nga farmacistët sipas kategorisë së ofruesit vërehet se farmacistët kanë marrë pjesën më të madhe të krediteve nga aktivitete të EV të ofruara nga Urdhri i Farmacistit.

**Grafiku 8. Kreditet e mbledhura sipas ofruesve për farmacistët**



Për infermierët pjesa më e madhe e krediteve është marrë nga aktivitete të organizuara nga OJF dhe shoqatat e profesionistëve.

**Grafiku 9. Kreditet e mbledhura sipas ofruesve për infermierët**



## 2.f. Ecuria e programit të certifikimit për infermierët dhe mamitë

VKM Nr 789 datë 22/09/2015 “Për Përcaktimin e Kritereve, Standardeve dhe Procedurave të Programit të Certifikimit për Profesionistë të Shëndetësisë” përcakton që brenda një cikli 4-vjeçar, infermierët e mamitë duhet të mbledhin një numër jo më të vogël se 40 kredite të edukimit në vazhdim. Numri i nevojshëm i krediteve që infermierët dhe mamitë e përfshirë në programin e certifikimit duhet të mbledhin deri në përfundim të ciklit sipas kategorive të aktiviteteve është deri në 20 kredite të përfituara nga aktivitete të edukimit në vazhdim të lidhura me profesionin, jo më shumë se 20 kredite të përfituara nga aktivitete të edukimit në distancë dhe deri në 8 kredite nga aktivitete të vetëraporuara. Për periudhën 2016-2019, VKM nuk ka përcaktuar detyrim minimal vjetor dhe viti 2018 është viti i tretë i ciklit të infermierëve dhe mamive. Kjo gjë ka bërë që infermierët të mos paraqesin interes në vitet e para të ciklit. Një arsye tjetër që kjo kategori profesionistësh nuk e ka përmbushur numrin minimal të rekomanduar për vit mund të jetë dhe mungesa e aktiviteteve të organizuar enkas për infermierë. Në tabelën 3 paraqitet situata e krediteve të marra nga infermierët për 3 vitet e para të ciklit 2016 – 2019:



**Tabela 3. Kreditet e marra nga infermierët në periudhën 2016-2019**

<b>Infermier</b>	<b>Kredite të marra 2016 - 2018</b>	<b>Në %</b>
Me kredite	13,785	38
Ndën rekomandimin (10 kredite në vit)	5,971	16
Mbi rekomandimin (10 kredite në vit)	7,814	21
Pa kredite	8,984	25
<b>Total</b>	<b>36,554</b>	<b>100</b>

**2.g. Profesionistët me detyrim të pakryer që duhej të kryenin provimin e certifikimit**

Profesionistët e shëndetësisë, të cilët nuk përmbushën detyrimet e ciklit të I-rë të certifikimit 2010 – 2014 duhet t'i nënshtrohen provimit të certifikimit. Provimi i certifikimit u organizua nga MShMS në bashkëpunim me fakultetet përkatëse të UMT dhe Urdhrat e Profesionistëve sipas modaliteteve të përcaktuara në rregulloren për organizimin e provimit të certifikimit të profesionistëve të shëndetësisë.

Në faqen zyrtare të QKEV u shpallën programet orientuese të provimit të certifikimit të cilat u hartuan nga departamentet përkatëse të Universitetit të Mjekësisë në bashkëpunim me Urdhrat profesionalë dhe shoqatat e profesionistëve.

Me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale u ngritën komisionet e provimit sipas profesioneve dhe specialiteteve. Në periudhën 2015-2018 janë organizuar 3 sesione provime certifikimi për mjekët dhe 4 për stomatologët dhe farmacistët, në të cilat kanë marrë pjesë vetëm 192 profesionistë siç paraqiten në tabelën 4.

**Tabela 4. Profesionistët që i janë nënshtuar provimit të certifikimit**


<b>Profesioni</b>	<b>Nr. i profesionistëve</b>	<b>Profesionistë të Certifikuar</b>
Mjek	49	49
Stomatolog	136	118
Farmacist	7	7
<b>Total</b>	<b>192</b>	<b>174</b>

Bazuar në raportin e përgatitur nga QKEV për ciklin e I-rë të certifikimit, profesionistët me detyrim të pakryer arrinin në 2,180, nga të cilët 1,212 mjekë, 760 stomatologë dhe 209 farmacistë. Pra, vetëm 8% e profesionistëve me detyrim të pakryer i janë nënshtuar provimit. Duhet verifikuar nga institucionet përgjegjëse se sa nga profesionistët me detyrim të pakryer vazhdojnë të ushtrojnë profesionin në sektorin publik ose privat.

### 3. AKREDITIMI I AKTIVITETEVE DHE OFRUESVE TË EDUKIMIT NË VAZHDIM

Gjatë viteve 2015-2018 ka pasur një vijimësi progresive të aktiviteteve të akredituara për profesionistët e shëndetësisë, siç paraqitet në grafikun 10. Vërehet një dyfishim i numrit të aktiviteteve nga viti 2015 në vitin 2018.

**Graf. 10 Numri i aktiviteteve edukimit në vazhdim të akredituara 2015-2018**



Rritja e numrit të aktiviteteve të akredituara është shoqëruar edhe me rritjen e forcimit e vazhdueshëm të kapacitetit të ofruesve, kryesisht shoqatave mjekësore, si dhe institucioneve akademike publike dhe private.

Nga numri i total i aktiviteteve të ofruara, një pjesë i takon aktiviteteve të akredituara që janë përsëritur në vijim. Një aktivitet i akredituar mund të përsëritet brenda një periudhe kohore prej tre vjetësh mbas akreditimit të tij nga QKEV-ja. Në total numri i aktiviteteve të përsëritura për periudhën 2015-2018, është rreth 1455 aktivitete, ndërsa vetëm për vitin 2018 ky numër ka qenë rreth 480 aktivitete të përsëritura.

Për vlerësimin nga pikëpamja shkencore të aktiviteteve të ofruara janë anagzhuar nga QKEV-ja një numër i madh ekspertësh të jashtëm, anëtarë të trupës shkencore dhe pedagogjike të UMT, por dhe institucioneve private akademike të edukimit të profileve të shëndetësisë, si psh Albanian University, UZKM, Universiteti Aldent etj. Ka një bashkëpunim mjaft të mirë me grupin e ekspertëve, në funksion të vlerësimit sa më objektiv të përmbajtjes së aktiviteteve.

QKEV-ja ka qenë e kujdesshme, që një vëmendje të veçantë t'i kushtojë respektimit të standardeve të cilësisë së aktiviteteve gjatë procesit të akreditimit të tyre, si dhe garantimit të zbatimit të standardeve të deklaruara, nëpërmjet monitorimit të shumë prej aktiviteteve. Për periudhën 4 vjeçare, numri i aktiviteteve, të cilëve iu është refuzuar apo anuluar akreditimi për shkelje të ndryshme të standardeve të akreditimit, shkon në rreth 38 aktivitete. Vetëm gjatë vitit 2018, u refuzua akreditimi për 8 aktivitete.

### 3.a. Ndryshimet e kryera në bazën ligjore të akreditimit

Në vitet 2015-2018 u miratuan nga Kuvendi i Shqipërisë disa ndryshime në ligjin “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu, u miratuan ndryshimet në VKM 788 datë 22/09/2015: “Për përcaktimin e kritereve, standardeve dhe procedurave të procesit të akreditimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë”. Miratimi i këtyre akteve ligjore u bë një shtysë për një punë më cilësore në akreditimin dhe monitorimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë.


Gjithashtu në këtë periudhë, QKEV propozoi kuadrin e ri ligjor për akreditimin e ofruesve të aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë. Mbas konsultimeve me aktorë të rëndësishëm të sistemit shëndetësor u përpiluan përfundimisht procedurat e akreditimit të këtyre ofruesve, të cilat u finalizuan në VKM 440 për “Përcaktimin e standardeve, të kritereve dhe procedurave të akreditimit të ofruesve të aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë” datë 17/05/2017. Qëllimi i hartimit të këtij Vendimi ishte promovimi i cilësisë në edukimin e vazhdueshëm përmes akreditimit të atyre ofruesve që kanë eksperiencë dhe kapacitete të spikatura në fushën e edukimit në vazhdim, duke bërë të mundur që të veprojnë si një lokomotivë e sistemit të edukimit në vazhdim.

### 3.b. Kategoritë e ofruesve të aktiviteteve të edukimit në vazhdim


Numërohen rreth 250 ofrues të aktiviteteve të edukimit në vazhdim përgjatë gjithë periudhës nga fillimi i programit të certifikimit. Në këtë numër të lartë ofruesish kanë kontribuar kryesisht institucionet publike të kujdesit shëndetësor, që kanë qënë vazhdimisht të nxitur të ofrojnë aktivitete të akredituara për zhvillimin profesional të stafëve të tyre, si dhe shoqatat e shumta profesionale për degët dhe nëndegët e ndryshme të speciliteteve mjekësore.

Numri i aktiviteteve të ofruara sipas kategorive të ofruesve paraqitet në grafikët e mëposhtëm


**Graf. 11 Numri i aktiviteteve sipas kategorive të ofruesve të edukimit në vazhdim 2015**




**Graf. 12. Numri i aktiviteteve sipas kategorive të ofruesve të edukimit në vazhdim 2016**



**Graf. 13 Numri i aktiviteteve sipas kategorive të ofruesve të edukimit në vazhdim 2017**



**Graf. 14 Numri i aktiviteteve sipas kategorive të ofruesve të edukimit në vazhdim 2018**




Siç vihet re dhe nga grafikët më sipër, ndër kategoritë më aktive në ofrimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim, në vitet 2015 e 2016, kanë qënë shoqatat e profesionistëve të shëndetësisë me një numër të madh të organizimit të këtyre aktiviteteve. Gjithashtu, dhe aktivitetet që janë zhvilluar nga OJF të ndryshme, kanë zënë një pjesë të konsiderueshme të totalit të aktiviteteve. Në vitin e katërt të ciklit vihet re një rritje e numrit të aktiviteteve të ofruara nga institucionet shëndetësore publike të nivelit të kujdesit parësor, dytësor dhe terciar. Kjo tendencë e ofrimit të aktiviteteve të edukimit shëndetësorë për stafet e profesionistëve nga vetë institucionet e kujdesit shëndetësor publik, ka pasur një vijshmëri gjatë këtyre 4 viteve vetëm falë mbështetjes së projektit “Shëndet për të gjithë”. Është vënë re një ulje e organizimit të aktiviteteve nga institucionet publike me përjashtim të qarqeve Fier dhe Dibër që janë mbështetur nga projekti.

Gjatë kësaj periudhe 4 vjeçare është vënë re se pavarësisht detyrimit ligjor të institucioneve të kujdesit shëndetësor (spitalet dhe qendrat shëndetësore) për ofrimin e aktiviteteve për stafet e tyre të profesionistëve, vetëm 4.4% tyre e kanë përmbushur këtë detyrim në vitin 2015, dhe në vitet e tjera 9,4% (2016), 16.8% (2017) dhe 9.8% (2018). Ky tregues sugjeron nevojën për një ndryshim rrënjësor në rritjen e përgjegjshmërisë dhe funksionim e mekanizmave të llogaridhënies së këtyre institucioneve.

Ka pasur rritje te dukshme dhe të aktiviteteve të ofruara nga Fakulteti i Mjekësisë Tiranë. Gjithashtu prej vitit 2018, QKEV ka regjistruar veçmas aktivitetet e ofruara nga biznese të ndryshme, duke parë numrin e konsiderueshëm të ofruar nga një apo disa ofrues të kësaj kategorie.

**Graf.15 Aktivitetet sipas Kategorive të Ofruesve për vitin 2018**



Për sa i takon disa prej institucioneve që kanë dalluar për numrin e madh të aktiviteteve të zhvilluara, mund të përmendim: Shoqatën Kombëtare të Shëndetit Publik; Shoqata për një Shqipëri të shëndetëshme, Fondacioni Santa Maria; Fondacionin “Shoqata e Kujdesit


Shëndetësor Familjar”, etj. Po ashtu shumë aktivitete janë zhvilluar nga ofrues si Qendra "Traditë Art dhe Shkencë", për kategorinë e infermiereve gjatë këtij 4-vjeçari.

QKEV-ja me mbështetjen e projektit “Shëndet për të Gjithë” ka punuar për ngritjen e kapaciteteve dhe fuqizimin e këtyre ofruesve, përgjatë gjithë kësaj periudhe. Në këtë kontekst, janë zhvilluar një sërë veprimtarish trajnuese për ofruesit e këtyre aktiviteteve si nga institucione publike të ofrimit të kujdesit shëndetësor, ashtu dhe nga ato private.

Pas miratimit të VKM 440 datë 17/05/2017 “Për përcaktimin e standardeve, të kriterëve dhe procedurave të akreditimit të ofruesve të aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë” i ndryshuar, filloi dhe akreditimi i ofruesve të aktiviteteve të edukimit në vazhdim. Deri në fund të 2018-s janë akredituar nga QKEV: Universiteti Mjekësor i Tiranës, Albanian University dhe Swiss Foundation for Innovation.


### 3.c. Aktivitetet e edukimit në vazhdim sipas llojit të tyre

Numri i aktiviteteve të ofruara gjatë periudhës 4 vjeçare sipas llojit paraqitet në grafikun 16.



Vihet re se në vitin e 2015 numri i konferencave ka qënë i përafërt me atë të trajnimeve. Në vitet në vijim numri i trajnimeve është rritur ndjeshëm. Ky zhvillim pozitiv është reflektim i politikës së ndjekur nga QKEV për të nxitur organizimin e aktiviteteve të këtij formati, si dhe të ndryshimeve ligjore që promovojnë aktivitetet me një numër më të vogël pjesëmarrësish si forma më efektive e edukimit. Ndërkohë, u vu re dhe një rënie e numrit të aktiviteteve on-line nga ofruesit e tyre kryesorë. Një paraqitje më të detajuar numri i aktiviteteve të ofruara sipas formatit të tyre për vitin 2018 jepet në grafikun 17.

**Graf. 17. Numri i aktiviteteve sipas llojit për vitin 2018**



Siç vihet re, është rritur dukshëm numri i aktiviteteve të formatit trajnim i ndjekur nga ai i aktiviteteve të formatit konferencë.

Konstatohet se aktivitetet e edukimit në distancë janë ende shumë të kufizuara megjithë përparësitë që ofron kjo formë edukimi. Në përgjithësi, aktivitetet on-line të akredituara deri tani nga QKEV janë bazuar në platforma të gatshme që ofron rrjeti dhe ishin të një formati shumë bazik, vetëm me materiale të paraqitura në formë leksionesh të paraqitura online dhe pa interaktivitet nga pjesëmarrësit.

Gjatë vitit 2015 janë ofruar 23 aktivitete të tilla, në vitin 2016 22 aktivitete, dhe gjatë vitit 2017 dhe 2018 janë ofruar vetëm 11 aktivitete për secilin vit. Ofruesit e aktiviteteve të edukimit në distancë kanë qënë: Qendra e trajnimit profesional mjeksor "Santa Maria", Shoqata Kombëtare e Shëndetit Publik, Shoqata Shqiptare e Ambjentalistëve, Urdhri i Farmacistëve, Instituti i Shëndetit Publik, Urdhri i Stomatologëve dhe Fakulteti i Mjekësisë.


Vihet re se interesi i profesionistëve të shëndetësisë për aktivitetet e edukimit në distancë është ende i ulët. Kjo lidhet së pari me ofertën e munguar dhe së dyti me mosnjohjen dhe ndërgjegjësimin e mjaftueshëm për avantazhet e kësaj forme edukimi.

Në periudhën 2015-2018 vetëm 2012 profesionistë kanë marrë pjesë në aktivite online të akredituara nga QKEV dhe 1821 të tjerë në aktivitete online të akredituara nga institucione të tjera akredituese. Ky numër është relativisht shumë i vogël në raport me numrin total të profesionistëve të shëndetësisë.

### **3.d. Aktivitetet e edukimit në vazhdim sipas target grupit**

Aktivitetet e edukimit në vazhdim sipas kategorive të profesionistëve paraqiten në grafikun e mëposhtëm.


**Graf. 18 Aktivitetet e edukimit në vazhdim sipas target grupit 2015-2018**



Siç shikohet, ka një rritje nga një vit në tjetrin të aktiviteteve multidisiplinare, si dhe aktiviteteve për mjekë të përgjithshëm dhe specialistë.

Pavarësisht se kërkesat për marrjen e krediteve kanë qënë uniforme për të gjitha vitet e ciklit të certifikimit, të gjitha kategoritë e profesionistëve kanë ndjekur më shumë aktivitete të akredituara në dy vitet e fundit dhe sidomos në vitin e fundit të ciklit. Ka qënë ky presion nga profesionistët e shëndetësisë, që në një farë mënyre ka nxitur, sidomos gjatë vitit të fundit, ofrimin e një numri gjithmonë e më të madh të këtyre aktiviteteve. Nga ana tjetër, ky presion ka shtuar rastet e deklarimit të shumë pjesëmarrësve në shumë aktivitete. Ky fenomen ka cënuar cilësinë e aktiviteteve dhe duhet të jetë në fokus të përpjekjeve për korrigjimin dhe gjetjes së instrumentave për ta minimizuar në të ardhmen. Ndërkohë, për vitin 2018, detaje mbi aktivitetet sipas kategorisë së profesionistëve paraqiten në grafikun 19.

**Graf. 19. Aktivitetet e edukimit në vazhdim sipas target grupit për vitin 2018**






Vërehet rritje e ndjeshme e aktiviteteve për farmacistë dhe dentistë, kjo falë një punë më të madhe të bërë në ofrimin e këtyre aktiviteteve kryesisht nga urdhrat profesionalë dhe shoqatat respektive për këto kategori profesionistësh. Gjithsesi, duhet përmendur që për këto dy kategori profesionistësh oferta e trajnimeve specifike ka qenë më e kufizuar. Gjithashtu numri i ofruesve të aktiviteteve për këta profesionistë është më i ulët, sidomos në rajone apo rrethe në periferi të territorit të vendit

### 3.e. Aktivitetet e edukimit në vazhdim sipas burimit financiar


Një tjetër element, që ka rëndësi në analizën e aktiviteteve të akredituara, është dhe mënyra e financimit të tyre (Grafiku 20). Vihet re një rritje e numrit të aktiviteteve që financohen nga kuotat e pjesëmarrjes në aktivitete të edukimit në vazhdim, të cilat përfaqësojnë burimin kryesor të financimit të aktiviteteve. Në rritje, por ende në vend të dytë është numri i aktiviteteve të financuara nga vetë organizata. Këtu hyjnë kryesisht aktivitetet e organizuara nga institucionet publike të kujdesit shëndetësor. Ndërkohë, është rritur dukshëm edhe numri i aktiviteteve të financuar nga donatorë, ku pjesa dërrmuese i takon aktiviteteve të formatit grupe rishikimi dhe forumet e menaxherëve të kujdesit parësor shëndetësor në qarqet e Fierit dhe Dibrës, me mbështetjen Kooperacionit Zviceran, nëpërmjet Projektit “Shëndet për të Gjithë”. Duhet thënë se, me përjashtim të financimit nga Kooperacioni Zviceran, tendenca e financimeve të aktiviteteve të edukimit në vazhdim nga donatorë të huaj ka ardhur në rënie.

**Graf. 20. Aktivitetet e edukimit në vazhdim sipas burimit financiar 2015-2018**



Ndërkohë, për vitin 2018-të, vihet re se dy burimet kryesore të financimit kanë qënë kuotat e pjesëmarrjes dhe buxhetet e vetë institucioneve akademike apo të kujdesit shëndetësor që kanë ofruar aktivitetet. Më poshtë jepet një paraqitje grafike e këtyre financimeve :

**Graf.21. Aktivitetet e edukimit në vazhdim sipas burimit financiar për vitin 2018**



#### **4. MONITORIMI I OFRUESVE DHE AKTIVITETEVE TË EDUKIMIT NË VAZHDIM**

Objektivi kryesor i QKEV-së si institucion akreditues gjatë periudhës 2015 – 2018, ka qenë garantimi i zbatimit të standardeve të cilësisë në zhvillimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim. Monitorimi gjatë zhvillimit të aktivitetit, qoftë i akredituar ose ende në proces akreditimi, është parë nga QKEV si një instrument i rëndësishëm në funksion të garantimit të cilësisë. QKEV ka monitoruar 542 aktivitete të edukimit në vazhdim gjatë katërvjeçarit. Numri i aktiviteteve të monitoruara ka ardhur në rritje edhe përmes angazhimit të koordinatorëve të rretheve që nga viti 2017.

Qëllimi kryesor i monitorimit të aktiviteteve të akredituara ose në proces ka qenë më së shumti mbështetja e ofruesve të këtyre aktiviteteve për të përmirësuar gjithmonë e më shumë standardet e edukimit në vazhdim dhe shmangia e shkeljeve të rënda si konflikti i interesit apo mospërputhje mes programit të deklaruar dhe atij të zhvilluar.

Përtej qëllimit të përgjithshëm të monitorimit, objektivat specifike të tij kanë qenë të orientuara nga problematikat e evidentuara, të ndryshme nga viti në vit dhe nga ofruesi në ofrues. Për këtë arsye rezultatet e monitorimit drejtuar ofruesve kanë qenë gjithnjë e më të detajuara.

Qasja e QKEV ndaj ofruesve të aktiviteteve ka qenë në funksion të promovimit të cilësisë. Gjatë periudhës 2015-2018 për 27 aktivitete që kanë reflektuar një përbushje maksimale të standardeve të cilësisë së edukimit në vazhdim është dhënë bonusi i vlerësimit me rritje të numrit të krediteve deri në 20%.

Dhjetra raporte monitorimi, gjatë këtij cikli, janë përcjellë me sugjerime dhe vërejtje. Gjithashtu ofrues të caktuar, të cilët gjatë monitorimeve të mëparshme kanë paraqitur probleme, janë monitoruar përsëri në vazhdim për të verifikuar nëse sugjerimet dhe vërejtjet e bëra nga QKEV ishin marrë në konsideratë ose jo.

QKEV pas kryerjes së procesit të monitorimit ka marrë masat e mëposhtme për shkeljet e konstatuara gjatë zhvillimit të aktiviteteve:

- Reduktim të numrit të krediteve për 26 aktivitete të edukimit në vazhdim.
- Anullim të akreditimit për 14 aktivitete të edukimit në vazhdim.
- Pezullim të ofruesit nga ofrimi i aktiviteteve të akredituara 6-12 muaj për 4 ofrues.

Krahas zhvillimeve pozitive si në punën e QKEV-së ashtu dhe në atë të organizatorëve të aktiviteteve të edukimit në vazhdim, mbeten ende disa fusha problematike që kanë marrë vëmendje gjatë procesit të monitorimit, të tilla si:

*Konflikti i interesit dhe përdorimi i mbështetjes tregëtare.* Nga viti në vit vihet re një përmirësim nga ana e ofruesve në zbatimin e kriterëve të konfliktit të interesit dhe përdorimit të mbështetjes tregëtare. Megjithatë, mosdeklarimi i konfliktit të interesit nga lektorët/trajnerët dhe keqpërdorimi i mbështetjes tregëtare duke përdorur emra tregtarë apo ndonjë material promocioal brenda mjedisit të aktivitetit vazhdojnë të mbeten probleme që shfaqen herë pas here mbase në forma të ndryshme dhe më indirekte se në fillimet e procesit të edukimit në vazhdim.

*Monitorimi i pjesëmarrësve.* Monitorimi i pjesëmarrësve nga ana e organizatorëve është një nga ato aspekte që paraqet realitete të ndryshme për lloje të ndryshme aktivitetesh dhe ofruesish. Ka nga ata ofrues që gjatë përvojës së tyre kanë zhvilluar mekanizma të brendshëm për të garantuar një pjesëmarrje të rregullt. Ndërkohë që për aktivitete të llojit të konferencës mbetet ende sfidë si për organizatorin ashtu dhe për QKEV-në monitorimi i duhur i pjesëmarrësve.

*Ndryshimet në program.* Ndryshimet në program ose vendndodhje të aktivitetit pa lajmëruar QKEV-në është një tjetër fenomen i përhapur te ofruesit, i cili shpesh shpjegohet me neglizhimin ndaj rregullave dhe kërkesave të akreditimit.

*Teknikat pedagogjike.* Pavarësisht ndërhyrjeve të vazhdueshme për të nxitur teknika interaktive të edukimit në vazhdim, referimi në formë leksioni është mënyra më e zakonshme e përdorur. Ndryshimet ligjore të 2018-tës që vlerësojnë me më shumë kredite aktivitetet e vogla do të nxisë përmirësimin edhe të këtij standardi në të ardhmen.

*Vlerësimi i aktivitetit.* Edhe pse vlerësimi i aktivitetit është bërë i detyrueshëm me ligj disa herë verehet neglizhencë në kryerjen e procesit dhe vlerësimin dhe përdorimin e informacionit të marrë nga ky proces.

Pas fillimit në vitin 2017-të të praktikës së akreditimit të ofruesve dhe marrjes së statusit të Ofruesit të Akredituar nga Universiteti i Mjekësisë, në vitin 2018, QKEV ka monitoruar ofruesin e akredituar. Monitorimi u fokusua në: verifikimin e dokumentacionit të procedurave të akreditimit për aktivitetet e akredituara nga UMT, monitorimin e aktivitetve të akredituara dhe zhvilluara nga UMT dhe verifikimin e kriterëve të tjera sipas legjislacionit në fuqi. Raporti i monitorimit bashkë me gjetjet e rekomandimet iu paraqit UMT dhe Bordit të Edukimit të Vazhdueshëm.

Monitorimi është një proces që nuk mund të zhvillohet për çdo aktivitet që ka marrë miratimin e krediteve nga QKEV ose që është në process akreditimi. Për këtë arsye, konstatimet e mësipërme nuk janë gjithëpërfshirëse, por nga ana tjetër janë mjaftueshëm treguese të realitetit, duke qenë se mbulojnë aktivitete të zhvilluara nga një grup kryesor ofruesish, përfaqësues të të gjitha kategorive dhe të shtrira në një periudhë 4-vjeçare. Ato sugjerojnë ndryshime e përmirësime si në punën e vetë QKEV-së ashtu dhe në atë të ofruesve të aktiviteteve të edukimit në vazhdim.

Disa nga drejtimet më të rëndësishme të punës së QKEV-së për vitet në vazhdim janë:

- Rishikimi e përshtatja e rregullave e procedurave të akreditimit në përputhje me nevojat e kërkesat e ngritura nga përvoja e deritanishme. Ky rishikim duhet të bëhet përmes një procesi konsultimesh me ofruesit dhe aktorët e tjerë të sistemit të edukimit në vazhdim dhe në funksion të rritjes së efektivitetit të procesit akreditues si dhe standardeve të cilësisë së aktiviteteve të edukimit në vazhdim.
- Organizimi i aktiviteteve informative mbi kriteret e akreditimit dhe standardet e cilësisë me kategoritë e ndryshme të ofruesve, me një fokus të veçantë mbi kriterin e konfliktit të interesit, teknikat pedagogjike dhe vlerësimin e nevojave të profesionistëve.
- Vlerësimi i aktiviteteve me anë të formularëve të vlerësimit për pjesëmarrësit sa herë që kjo gjë është e mundur për çdo aktivitet të monitoruar. Përfundimet e këtij vlerësimi duhet të bëhen pjesë e rezultateve të monitorimit dhe procesit të akreditimit të aktivitetit.
- Rritja e numrit të monitorimeve për aktivitete që zhvillohen në rajone të ndryshme të Shqipërisë për të ndihmuar kështu përmirësimin e cilësisë së punës së disa ofruesve lokalë.
- Monitorimi i Ofruesve të Akredituar dhe kontakti e bashkëpunimi i vazhdueshëm midis koordinatoreve të tyre dhe QKEV për të arritur një edukim në vazhdim me standarde të larta e cilësi gjithnjë në rritje.

## **5. KOMUNIKIMI ME PROFESIONISTËT DHE AKTORËT E TJERË**

QKEV ka punuar për rritjen e përmirësimin e komunikimit me të gjithë aktorët, në vecanti me profesionistët e shëndetësisë. QKEV ndan rregullisht informacion me profesionistët e

shëndetësisë në lidhje me kriteret dhe detyrimet e programit të certifikimit, gjendjen aktuale të krediteve si nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë ashtu edhe përmes postës elektronike, rrjeteve sociale, mediave.

Në faqen zyrtare të QKEV dhe në rrjetet sociale në mënyrë periodike janë pasqyruar të gjitha aktivitetet e akredituara nga QKEV, datat, vendet ku do të zhvillohen dhe gjithë të dhënat relvante në mënyrë që profesionistët e shëndetësisë të kenë mundësi të informohen për aktivitetet që ndodhin, të zgjedhin ato që përmbushin më mirë nevojat e tyre.

Profesionistët e shëndetësisë janë informuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose postë elektronike për detyrimet, kreditet, ndryshimet e bëra në ligj, etj. Janë pritur një numër i konsiderueshëm profesionistësh të shëndetësisë të cilëve ju është shërbyer në kohë dhe me efikasitet duke i regjistruar në programin e certifikimit, duke i informuar për gjendjen e krediteve ose duke i pajisur me vërtetimet përkatëse.

Janë pritur personalisht pranë zyrës së informacionit të QKEV rreth 15000 profesionistë të shëndetësisë gjatë viteve 2015-2018. Profesionistët e shëndetësisë të cilët janë licencuar për herë të parë janë regjistruar dhe orientuar për detyrimet e të drejtat.

Profesionistët e shëndetësisë të cilët kanë qenë dhe janë pjesë e Programit të Certifikimit janë informuar në mënyrë të vazhdueshme për kreditet e marra dhe ato që detyrohen, duke shqyrtuar certifikatat e përfituara nga aktivitetet e edukimit në vazhdim si brenda dhe jashtë vendit, duke u orientuar për plotësimin e formularit të vetëraportimit.

Në mënyrë periodike u janë kërkuar institucioneve shëndetësore publike dhe private listat e përditësuara të profesionistëve me të gjithë të dhënat për arsye të përmirësimit të Regjistrat Kombëtar të Certifikimit. Çdo vit u është dërguar informacion i detajuar për secilin nga profesionistët e shëndetësisë ( nr.i krediteve, detyrimi në vite etj.) QKEV ka pasur një kontakt të vazhdueshëm me Urdhrat Profesionalë për shkëmbimin e të dhënave të profesionistëve.

Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim me mbështetjen e Projektit Zvicëran “Shëndet për të gjithë” ka organizuar rreth 15 takime informuese, workshop-e me tematika të ndryshme me qëllim përmirësimin e standardeve të edukimit në vazhdim dhe informimin e aktorëve të ndryshëm të edukimit në vazhdim mbi ndryshimet ligjore sipas rastit.

Vëmendje të vecantë ka marrë dhe mbajtja e kontakteve të ngushta me mediat e shkruara dhe audiovizive në mënyrë që të përçohet qartë dhe në kohë detyrimi që profesionistët e shëndetësisë kanë për edukimin e vazhdueshëm të tyre.

## **6. REKOMANDIME**

Në përfundim të ciklit të dytë të certifikimit 2015-2019 QKEV vlerëson se përmirësimi dhe forcimi i sistemit të edukimit në vazhdim duhet të përqëndrohet në drejtimit e mëposhtme:

1. Së pari, forcimi i rolit të institucioneve shëndetësore në lidhje me edukimin në vazhdim mbetet sfida madhore e sistemit. Në kushtet kur më pak se 20% e spitaleve dhe qendrave shëndetësore kanë përmbushur detyrimet ligjore për edukimin në vazhdim, sigurimi i zbatimit të ligjit nga ana e tyre është prioritet madhor. Përgjegjësitë e institucioneve shëndetësore janë të shumëfishta dhe përfshijnë: planifikimin dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese për personelin e tyre mjekësor, informimin dhe ndërgjegjësimin e profesionistëve për kriteret e certifikimit dhe lehtësimin e procesit të edukimit në vazhdim për profesionistët. Nga ana e saj, QKEV do të vazhdojë të punojë për zhvillimin e kapaciteteve të koordinatorëve të edukimit në vazhdim në DSHP/DRSH dhe spitalet rajonale në mënyrë që ata të kryejnë sa më mirë detyrat e tyre, përfshirë planifikimin, hartimin dhe ofrimin e aktiviteteve institucionale të edukimit në vazhdim për personelin e tyre. Megjithatë, pa angazhimin efektiv të drejtuesve të spitaleve dhe qendrave shëndetësore si dhe pa funksionimin e mekanizmave të llogaridhënies për detyrat që u ngarkon ligji për edukimin në vazhdim, nuk mund të sigurohet mbarëvajtja e sistemit.
2. Forcimi i kapaciteteve të ofruesve për zhvillimin e aktiviteteve cilësore sipas standardeve të aktiviteteve të edukimit në vazhdim përfaqëson gjithashtu një sfida të rëndësishme. Fillimi i zbatimit të procesit të akreditimit të ofruesve besojmë se do të ndihmojë dhe promovojë rritjen dhe forcimin e kapacitetit të tyre. Praktika e akreditimit të ofruesve nxjerr në pah një nevojë ende të madhe të ofruesve aktualë për të rifreskuar njohuritë në lidhje me vlerësimin e nevojave, planifikimin, vlerësimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim dhe për të respektuar kritere të tjera të akreditimit. Gjithashtu, numri shumë i kufizuar i ofruesve të akredituar deri tani sugjeron nevojën për të identifikuar incentiva për ofruesit aktualë që të marrin statusin e ofruesit të akredituar. Marrja e statusit të ofruesit të akredituar është një garanci më shumë për cilësinë e edukimit në vazhdim.
3. Zhvillimi i mëtejshëm i alternativës së edukimit në distancë ka qenë dhe mbetet sfida e sistemit të edukimit në vazhdim. Përpjekjet dhe ndërhyrjet e filluara disa vjet më parë nga projekti “Sistemi i Zhvillimit Profesional” nuk kanë vijuar në vitet e fundit. Forcimi i kriterëve të akreditimit të këtyre aktiviteteve kanë bërë të mundur që këto aktivitete të jenë konform standardeve. Kjo alternativë edukimi duhet të marrë një përdorim më të gjerë, duke patur parasysh që ajo krijon lehtësira të mëdha për profesionistët që t’i ndjekin aktivitetet aty dhe atëherë kur ata e kanë më të përshtatshme. Nëse nuk do të ketë një mbështetje serioze për rritjen e kapaciteteve të ofruesve për edukimin në distancë dhe sigurimin e një infrastrukture të nevojshme për këtë formë edukimi, nuk mund të parashikohet ndonjë zhvillim i ndjeshëm në këtë drejtim. QKEV beson se kjo është një fushë që kërkon më shumë mbështetje teknike.
4. Rritja e financimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim përmes projekteve të ndryshme nga buxheti i shtetit është një investim largpamës dhe kostoefektiv. Ndonëse rezultatet e këtij investimi nuk janë të menjëhershme siç mund të jenë ato të investimeve në infrastrukturë, efektet dhe rezultatet e investimit në edukimin në vazhdim janë të qëndrueshme dhe cilësore në shërbimet shëndetësore.